

Në mbështetje të nenit 12 par. 1.2 dhe nenit 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës:

RISHPALL KONKURS

Titulli i vendit të punës:

Departamenti:

Kategoria funksionale dhe grada:

Pozitë:

Nr. i referencës së vendit të punës:

Vendi:

Një (1) zyrtar i vlefshmërisë ajrore

i Sigurisë së Fluturimeve

AAC-4

Jo e karrierës

(Kohëzgjatja e kontratës deri më 31/12/2015)

AACK-ADM-BNJ/01/2015

AAC, Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm:

Ndihmon në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve, inspektimeve dhe mbikëqyrjen e vlefshmërisë ajrore të operatorëve të mjeteve ajrore, organizatave të mirëmbajtjes së vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme, organizatave të aprovuara të mirëmbajtjes, organizatave dizajnuese dhe prodhuese, organizatave trajnuese Pjesa-147, organizatave të përfshira në transportimin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit dhe licencimin e personelit Pjesa-66.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkrahje inspektorëve në certifikimin e organizatave për mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe komponentëve të tyre (Part-145) në pajtueshmëri me kushtet e përshkruara;
- Përkrahje inspektorëve në certifikimin e organizatave të cilat menaxhojnë vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme të mjeteve ajrore (CAMO) në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara;
- Përkrahje inspektorëve në aprovimin e programeve për mirëmbajtje të mjeteve ajrore;
- Përkrahje inspektorëve në aprovimin e Listës Minimale të Pajisjeve (MEL) të mjeteve ajrore brenda fushëveprimit të Departamentit;
- Përkrahje në miratimet e transportuesve ajrorë dhe certifikimet e transportuesve ajrorë dhe aprovimet speciale ajrore (RVSM, CAT II, CAT III, MNPS, ETOPS, RNAV, etj.) brenda fushëveprimit të punës;
- Zbatimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme mbi të gjithë mbajtësit e certifikatave në pajtim me kushtet e përcaktuara;
- Pjesëmarrje në inspektimet dhe dhënia e rekomandimit Drejtorit të Departamentit për lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore dhe certifikatave të verifikimit të vlefshmërisë ajrore;
- Dhënien e rekomandimit Drejtorit të Departamentit për certifikimin e organizatave dizajnuese dhe prodhuese (Part-21);
- Mbledhjen, procesimin, analizimin dhe publikimin e ndodhjeve në aviacion;
- Regjistrimin e mjeteve ajrore në regjistrin kombëtar të mjeteve ajrore civile;
- Vlerësimin e kushteve për bartjen e Mallrave të Rrezikshme (DG);

Shkollimi i kërkuar:

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Diplomë universiteti të fushës së studimit të aeronautikës, mekanikës, inxhinierisë elektrike, apo elektronikës;
- Tre vite përvojë pune, prej të cilave së paku një vit përvojë pune në një ambient rregullator;
- Njohuri të domosdoshme të cilat ndërlidhen me Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë (SMS) si dhe Programeve Shtetërore të Sigurisë (SSP);
- Njohuri të theksuara të teknikave të auditimit;
- Njohuri të shkëlqyeshme të ambientit ndërkombëtar të sigurisë së aviacionit (standartet, praktikat e rekomanduara dhe dokumentet e ICAO-së), ambientit rregullator të BE-së (Rregullorja 216/2008, Rregullorja 748/2012, Rregullorja 1321/2014 dhe Mjetet e Pranueshme të Përmbushjes dhe Materialet Udhëzuese të EASA-së) dhe legjislacionit e procedurave administrative nacionale;
- Njohuri të theksuara të Aneksëve 1, 6 dhe 8 të ICAO-s;
- Kryerje me sukses të trajnimit në vend të punës dhe trajnimeve të specializuara sipas kërkesave të manualit të inspektorëve;
- Njohuri të mira të Microsoft Office-it, programeve Word, Excel, PowerPoint, etj;
- I/e rrjedhshëm/ me në shqip, anglisht dhe serbisht;
- Komunikim të zhvilluar (me shkrim dhe me gojë), aftësi ndërpersonale dhe Përfaqësuese;
- Aftësi të demonstruara analitike, duke përfshirë aftësinë për të adoptuar një qasje sistematike për zgjidhjen e problemeve në një mjedis teknik kompleks;
- Gatishmëri për angazhim në arritjen e objektivave të AAC-së në lidhje me rregullimin e funksioneve të sigurisë, duke përfshirë edhe aftësi të demonstruar për t'u përshtatur pozitivisht dhe të ndihmojë në ndryshime;
- Aftësi të dëshmuar të punës në mënyrë efektive në një mjedis me ekip shumëdisiplinor.

Karakteristikat e pazakonta të mjedisit

- Ekspozimi ndaj zhurmave të mëdha të shkaktuara nga motorët e aeroplanëve;
- Rreziku potencial ndaj shtytjes e cila mund të shkaktohet nga motorët reaktivë apo me propeler;
- Rrezik i ekspozimit ndaj mallrave të rrezikshme të cilat barten me aeroplan;
- Ekspozimi në kushte të vështira atmosferike gjatë inspektimeve dhe auditimeve të Aeroportit dhe Operatorëve Ajrorë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës, personat e moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprimit, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësi fizike dhe profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen nga pozitat përkatëse.

Procedurat e rekrutimit

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë shërbyesit civilë ekzistues dhe personat e jashtëm të cilët i plotësojnë kushtet e nevojshme për konkurrim.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Procesi i rekrutimit për këtë lloj pozite është i bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe Rregulloren e brendshme të AACK-së.

Të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara, do t'i nënshtrohen shqyrtimin fillestar të aplikacioneve të tyre. Vetëm kandidatët të cilët për zgjidhen në listën e ngushtë, do të kontaktohen.

Kohëzgjatja e emërimit

Emërimi është me afat të caktuar deri më 31 dhjetor 2015 .

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e shpalljes në gazeta të përditshme kosovare dhe në faqen zyrtare të AACK-së në internet.

Data e fundit për aplikim është 02 maj 2015, deri në ora 16:00

Të gjitha aplikacionet e kompletuara, të dërguara deri më këtë datë, do të konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave

- Formularët e aplikimit mund të merren nga faqja zyrtare e AACK-së në internet, në www.caa-ks.org/vende-pune, ose në selinë e AACK-së, Rr. Ahmet Krasniqi, p.n, Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, deri në ditën e fundit për konkurrim.
- Aplikacionet dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet personale mund të dorëzohen nëpërmes postës elektronike në e-adresën: **Safete.Selmani@caa-ks.org** ose në adresën postare të cekur më lart, me shënimin "**Për rekrutim - pozita në të cilën konkuroni**". Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për informata plotësuese mund të kontaktoni në 038 248 629 lok. 106.